

LIGJ
Nr.7718, datë 3.6.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.3766, DATË 17.12.1963 "PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR DHE DHËNIEN FALAS TË NDIHMËS MJEKËSORE TË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Titulli i këtij ligji bëhet:
"Për kujdesin shëndetësor"

Neni 2

Në ligjin nr.3766, datë 17.12.1963 "Për shërbimin shëndetësor dhe dhënien falas të ndihmës mjekësore të shtetit", neni 2 ndryshohet si vijon:

"Kujdesi shëndetësor realizohet nga shërbimi shëndetësor i cili jep ndihmën e nevojshme mjekësore".

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi shëndetësor organizohet në institucione të ndryshme shëndetësore shtetërore dhe private".

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Institucionet e ndryshme shëndetësore shtetërore krijohen dhe mbyllen me miratim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit".

Neni 5

Pas nenit 4 shtohet neni 4/a me këtë përmbajtje:

"Institucionet e ndryshme shëndetësore private dhe personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që e ushtrojnë mjekësinë në mënyrë private, duhet të pajisen me licencën përkatëse nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit".

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcaktojnë rregullat e nevojshme për dhënien e lejeve profesionale në fushën e shëndetësisë".

Neni 6

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Kujdesi shëndetësor i shtetit sigurohet nëpërmjet edukimit shëndetësor, kontrollit dhe masave profilaktike të përgjithshme, të veçanta dhe institucioneve përkatëse, asistencës së përgjithshme mjekësore (në shtëpi ose ambulatorisht), diagnostikimit, mjekimit dhe rehabilitimit të të sëmurit,

disiplinimit të eksperimenteve dhe të informacionit shkencor.

Llojet e shërbimeve shëndetësore që sigurohen kundrejt shpërblimit, si dhe masa e forma e këtij shpërblimi përcaktohen me ligj.

Neni 7

Neni 9 shfuqizohet.

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Ndihma mjekësore u jepet, kundrejt shpërblimit, shtetasve të huaj sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Bëhet përjashtim për shtetasit e huaj, me shtetet e të cilëve ka marrëveshje të ndërsjelltë, për shtetasit e huaj që kontribuojnë drejtpërdrejt me ndihma humanitare për vendin tonë, si dhe për disa kategori të veçanta shtetasish të huaj që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Neni 8

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 9

Në këtë ligj fjalët "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë" zëvendësohen me fjalët "Republika e Shqipërisë".

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.572, datë 26.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.